



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

Бр. Nr. 08-4126

31. 03. 2026 20

СКОПЈЕ - SHKUP



Në bazë të Nenit 4 të Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për zbatimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit nr. 08-757/1 të datës 26.01.2026, dhe në lidhje me Programin për aktivitete në fushën e sportit dhe të rinjve në Qytetin e Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25 dhe 3/26), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e mjeteve financiare për programe, projekte, aktivitete programore dhe manifestime në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026

1. Lëndë e Thirrjes publike

1.1. Lëndë e thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare për realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve programore në fushën e sportit dhe të rinjve me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e sportit, si dhe manifestimet dhe afirmimin e qytetit të Shkupit si qendër sportive zhvillimore me karakteristika evropiane, në fushat e mëposhtme:

a) Manifestime sportive tradicionale

b) Manifestime me interes të veçantë për Qytetin e Shkupit

c) Programe, projekte, aktivitete programore dhe manifestime për personat me aftësi të kufizuara në territorin e qytetit të Shkupit

ç) Sport cilësor dhe garues i ligës së parë dhe klubeve sportive me trofe në territorin e qytetit të Shkupit

d) Programe, projekte, aktivitete dhe manifestime nëpërmjet zhvillimit të sporteve shkollore në shkollat e mesme në qytetin e Shkupit

dh) Sporte masive dhe rekreative

e) Sporte urbane dhe ekstreme

1.2. Mjetet financiare për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026 sigurohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026.

1.3. Metoda, kriteret dhe procedura për ndarjen e mjeteve financiare të dedikuara për zbatimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026 janë përcaktuar në Rregulloren për metodën, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për zbatimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit nr. 08-757/1 nga 26.01.2026.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë klube sportive, shoqata sportive, institucione sportive (në tekstin e mëtejshëm: persona juridikë), të regjistruar në Regjistrin Qendror me seli në qytetin e Shkupit, të cilët i plotësojnë kriteret e Rregulloreve dhe kanë depozituar dokumentacionin e nevojshëm.

3. Kushte dhe kriteret për pjesëmarrje në Thirrjen publike

3.1. Aplikantët mund të depozitojnë aplikim për fushat e listuara nga nënpika 1.1. e kësaj Thirrjeje Publike.

3.2. Aplikimet e depozituara duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe pikësimin të cilat janë pjesë përbërëse e Rregulloreve, të cilat do të shpallen në ueb faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).

4. Dokumentacioni i nevojshëm

4.1. Për të marrë pjesë në Thirrjen publike, aplikanti duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Aplikacion i plotësuar (aplikacioni do të publikohet në ueb faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- Programin dhe planin financiar për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve dhe manifestimeve sportive;
- Aktvendimin për kryerjen e aktiviteteve sportive (për klubet sportive), i lëshuar nga Ministria e Sportit (Agjencia për rini dhe sport);
- Kopje të Vendimit për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Kopje të Gjendjes aktuale të subjektit jo më i vjetër se 6 muaj, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Numrin e telefonit për kontakt, adresa dhe adresa e email-it;
- Vërtetimin nga banka për llogari transaksionale aktive të subjektit sportiv;
- Vërtetimin që subjekti sportiv është anëtar i federatës përkatëse kombëtare sportive (për klubet sportive) dhe nëse subjekti sportiv merr pjesë me programet dhe aktivitetet e tij në një ligë garuese të organizuar nga federata përkatëse kombëtare sportive, duhet të dorëzohet vërtetimi nga federata në lidhje me renditjen ranguese në garë;
- Listë referencash për sukseset dhe rezultatet sportive në tre vitet e fundit, e mbështetur nga prova nga federatat përkatëse kombëtare sportive ose institucione të tjera sportive.

5. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

5.1. Për realizimin e procedurës pas thirrjes publike, Kryetari i Qytetit të Shkupit do të formojë Komision për realizimin e procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për programe, projekte, aktivitete programore dhe manifestime në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026 (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

5.2. Aplikimet që do të dorëzohen me vonesë, ato të pa kompletuara ose të plotësuara manualisht dhe që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni do t'i refuzojë me një Konkluzion dhe do t'i njoftojë aplikuesit me shkrim.

5.3. Për aplikimet që janë të kompletuara, të dorëzuara në kohë dhe që i plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni do t'i dorëzojë propozim Kryetarit të Qytetit të Shkupit për ndarjen e mjeteve financiare aplikuesve.

5.4. Komisioni do të pranojë aplikimet të cilat, në pajtim me kriteret dhe listat e pikëve të përcaktuara në Rregulloren, do të sigurojnë të paktën 60 pikë.

5.5. Me propozim të Komisionit, Kryetari i Qytetit të Shkupit do të miratojë Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për programe, projekte, aktivitete programore dhe manifestime në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026.

6. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikimeve

6.1. Thirrja publike publikohet në ueb faqen e internetit të Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).

6.2. Thirrja publike do të zgjasë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit.

6.3. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në një zarf të mbyllur përmes Arkivit të Qytetit të Shkupit, çdo ditë pune ose në adresën bul. Ilinden 82 – 1000 Shkup, me para shënimin – deri te Sektori për veprimtari publike - Komisioni për realizimin e procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për programe, projekte, aktivitete programore dhe manifestime në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026.

6.4. Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që mund të identifikojë aplikantin.

6.5. Aplikimi me dokumentacionin e kërkuar dorëzohet në një kopje origjinale, të plotësuar në formë elektronike, të nënshkruar dhe të vërtetuar/vulosur nga personi përgjegjës i aplikantit - personi juridik.

6.6. Informacione shtesë mund të merren në telefon në numrat e telefonit 02/3297-238 dhe 3297-320.

QYTETI I SHKUPIT

